

SH.A ALBPETROL

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE): “INET” shpk me NUIS K81607039F ,me adresë: Njësia Bashkiake nr 5, Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 3 ,Tiranë

Tipi i Kontratës: Kontratë furnizimi

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar

Numri i Procedurës /referenca e Lotit: REF-34894-12-30-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Ngritja e sistemit të raportimit për prodhimin e naftës bruto për shoqërinë Albpetrol sh.a”, 6 muaj implementimi dhe tre vjet mirëmbajtje.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 31.12.2024

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Nr.92 datë 31 Dhjetor 2024

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë kane marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “3i-Solutions” shpk me NUIS L52305007S, me vlerë oferte në total 38,531,500 lekë (tridhjetë e tetë milion e pesëqind e tridhjetë e një mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.
2. Bashkimi i operatorëve (BOE): “A-T-D - ALBANIAN TECHNOLOGY DISTRIBUTION” Sh.p.k. me NUIS L21811033B dhe “SINTEZA CO” shpk me NUIS K11324003F, me vlerë oferte në total 37,850,000 (tridhjetë e shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik “INET” shpk me NUIS K81607039F me vlerë oferte në total 44,900,000 (dyzet e katër milion e nëntëqind mijë) lekë pa TVSH .

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori ekonomik “3i-Solutions” shpk me NUIS L52305007S nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit, konkretisht:
 - Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur furnizime te mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogel se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kontrata e ngjashme dhe faturat e paraqitura rezultojne jashte afatit 3-vjecar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kjo ne kundërshtim me kriterin 2.3.1 te pikes 2.3 Aftesite Teknike dhe Profesionale.
- Bashkimi i operatorëve (BOE): “A-T-D - ALBANIAN TECHNOLOGY DISTRIBUTION” Sh.p.k. me NUIS L21811033B dhe “SINTEZA CO” shpk me NUIS K11324003F nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt administrativo-ligjor e teknik, në përputhje me kërkesat për kualifikim të DST dhe rregullat e prokurimit, konkretisht:
 - “A-T-D - ALBANIAN TECHNOLOGY DISTRIBUTION” shpk si pjese e BOE nuk ka paraqitur asnje furnizim te mëparshem të ngjashem ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes se deklaruar ne marreveshjen e bashkimit te operateve, kjo ne kundërshtim me kriterin 2.3.1 te pikes 2.3 Aftesite Teknike dhe Profesionale te DST-se, ku citohet se operatorët duhet te paraqesin Furnizime te mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogel se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës
 - BOE: “A-T-D - ALBANIAN TECHNOLOGY DISTRIBUTION” shpk” dhe “SINTEZA CO” shpk nuk kane deklaruar ne Formularet Permbledhes te Vetedeklarimit stafin e çertifikuar me certifikatat perkatese te kerkuara, kjo ne kundërshtim me kriterin 2.3.5. të pikës 2.3 Aftesite Teknike dhe Profesionale të DST-së, ku cilesohet se:

Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën 7 (shtatë) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/Teknologji Informacioni/ Informatikë/ Informatikë Ekonomike/ Telekomunikacion, si dhe staf të çertifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- 3(tre) zhvillues të çertifikuar në nivel profesionist, si VM ware Spring Professional 2023/ Java SE 11/ ose ekuivalente.
- 1(një) ekspert në menaxhimin e të dhënave dhe analitikës i çertifikuar si Google Professional Data Engineer/ MCSE/ ose ekuivalente.
- 1 (një) menaxher projekti me njohuri të avancuara në sistemet e sigurisë së informacionit, i diplomuar në nivel master, në Siguri Informacioni.
- 1 (një) punonjës të çertifikuar si auditues i sistemeve të informacionit.
- 2 (dy) punonjës të çertifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikatë.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.9.

* * *

Duke iu referuar procedures: së lartpërmendur, informojmë OE “INET” shpk me NUIS K81607039F, me adresë: Njësia Bashkiake nr 5, Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 3, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 44,900,000 (**dyzet e katër milion e nëntëqind mijë**) lekë pa TVSH, është identifikuar si Ofertë e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.